

# Mesazhet kryesore për institucionet e kujdesit afatgjatë - mjeku dhe menaxherët

---

## Detyrat

---

Detyrat kryesore për të përmirësuar përdorimin e antibiotikëve në institucionin tuaj përfshijnë:

1. Edukimin e stafit mjekësor dhe infermieror, duke u fokusuar në fushat ku keqpërdorimi i antibiotikëve është më i shpeshtë [109,110]:

- profilaksinë me antibiotikë;
- përdorimin e antibiotikëve te pacientët asimptomatikë me kultura pozitive (kolonizim);
- antibiotikët për përdorim lokal; dhe
- rastet e përdorimit të antibiotikëve në periudha shumë të gjata kohore.

2. Edukimin e pacientëve dhe familjeve të tyre mbi rreziqet e përdorimit të panevojshëm të antibiotikëve, që ndikon në selektimin e baktereve rezistente ndaj antibiotikëve (p.sh. bakteriuaria asimptomatike, infeksionet virale të traktit respirator) [109,110].

3. Përdorimin e shtigjeve klinike (clinical pathways) dhe udhëzimeve të bazuara në prova për diagnostikimin, trajtimin dhe menaxhimin e infeksioneve më të zakonshme (p.sh. pneumonia, infeksionet e traktit të sipërm respirator, infeksionet e lëkurës dhe indeve të buta dhe infeksionet e traktit urinar), duke marrë parasysh të dhënat lokale të ndjeshmërisë antimikrobike [109].

4. Rivlerësimin e trajtimeve me antibiotikë në varësi të gjendjes klinike të pacientit pas 48–72 orëve, ose sapo të jenë në dispozicion rezultatet mikrobiologjike, [31,42,70-72]:

- për të kaluar në një antibiotik me spektër të ngushtë;
- për të vazhduar ose të ndaluar terapinë me antibiotikë;
- për të kaluar në terapinë orale me antibiotikë.

5. Shmangien e testeve diagnostikuese dhe kulturave mikrobiologjike te pacientët asimptomatikë [56,111].

## Çka mund të bëni?

---

6. Zbatoni masat e parandalimit dhe kontrollit të infeksioneve së bashku me profesionistët e parandalimit dhe kontrollit të infeksioneve [konsensusi i ekspertëve].

7. Merrni anamnezën e plotë të pacientit kur përshkruani një antibiotik, duke përfshirë përdorimin e fundit të antibiotikëve, alergjitë ndaj ilaçeve, përdorimin e terapisë imunosupresive dhe faktorët e rrezikut për rezistencën ndaj antibiotikëve (p.sh. a ka pasur pacienti ndonjë spitalizim, procedurë mjekësore ose udhëtim jashtë Evropës në kohën e fundit) [31].

8. Gjithmonë kryeni ekzaminimin klinik të pacientit para se të përshkruani një antibiotik [31].

9. Nëse keni dyshime para se të përshkruani një antibiotik, duhet [25,26,53,70] [konsensusi i ekspertëve]:

- Të kontrolloni të dhënat epidemiologjike lokale, rajonale dhe kombëtare;
- Të kërkonti udhëzime dhe këshilla nga një koleg me më shumë përvojë ose një anëtar i ekipit të administrimit të përgjegjshëm antibiotikëve (Kujdestarisë së Antibiotikëve).

10. Të filloni trajtimin me antibiotikë vetëm nëse ka prova të një infeksioni bakterial dhe mos e trajtoni kolonizimin me baktele [31].

11. Të shmangni profilaksinë e panevojshme me antibiotikë (p.sh. profilaksinë e infeksionit të traktit urinar) [111].

12. Të siguroheni që kulturat përkatëse për ekzaminime laboratorike të merren para fillimit të trajtimit me antibiotikë [31,42,70,71].

13. Të dokumentoni indikacionet për trajtimin me antibiotikë, përzgjedhjen e ilaçit, dozën, mënyrën e administrimit dhe kohëzgjatjen e trajtimit, në fletëregjistrin e pacientëve [31,42,70,71].

14. T'u përgjigjeni pyetjeve kryesore të mëposhtme kur e rivlerësoni terapinë me antibiotikë pas 48-72 orësh (ose sapo të jenë në dispozicion rezultatet mikrobiologjike) [42,70]:

A ka pacienti një infeksion që mund të trajtohet me antibiotikë?

Nëse po:

i. A është duke marrë pacienti antibiotikun(ët) e duhur, në dozën e saktë dhe me rrugën e përshtatshme të administrimit?

ii. A mund të përdoret një antibiotik me një spektër më të ngushtë për të trajtuar infeksionin?

iii. Për sa kohë duhet të marrë pacienti antibiotik(ë)?

15. Promovoni programet e vaksinimit për banorët dhe stafin [konsensusi i ekspertëve].

16. Zbatoni masat e parandalimit dhe kontrollit të infeksioneve që janë vendosur tashmë në institucionin tuaj. Nëse shihni anëtarë të stafit tuaj që shkelin udhëzimet ose protokollet, pyetini pse po e bëjnë këtë dhe sigurojuni mjete për të kuptuar se çfarë po bëjnë gabim [69] [konsensusi i ekspertëve].

17. Merrni pjesë rregullisht në kurse trajnimi dhe në takime që mbështesin: a) përdorimin e përgjegjshëm të antibiotikëve, b) udhëzuesit lokal të antibiotikëve që bazohen në prova dhe c) masat e parandalimit dhe kontrollit të infeksioneve [52,53].

18. Organizoni ngjarje dhe fushata edukative që u ofrojnë banorëve informacione mbi përdorimin optimal të antibiotikëve.

19. Sigurohuni që banorët (dhe familjet e tyre) të kuptojnë arsyet e terapisë me antibiotikë dhe këshillat kryesore që lidhen me përdorimin e antibiotikëve, duke përfshirë [konsensusin e ekspertëve]:

- a) Të marrin antibiotikët saktësisht siç përshkruhet nga mjeku;
- b) Të mos ruajnë kurrë antibiotikë për përdorim të mëvonshëm;
- c) Të mos përdorin kurrë antibiotikë të mbetur nga trajtime të mëparshme;
- d) Të mos shkëmbejnë kurrë antibiotikët e mbetur me banorë ose njerëz të tjerë.

20. Organizoni rregullisht auditime/sondazhe të praktikave të përshkrimit të antibiotikëve dhe të infeksioneve që merren gjatë kujdesit shëndetësor [93].